



Prishtinë, 30 tetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1066_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (LIGJI Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 23, paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë elektrike (LIGJI Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 8, paragrafi 2 të Licencës për Operatorin e Tregut të energjisë Eelektrike ZRRE/Li_16/17;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit "Rregullat e Tregut v3.0";

në seancën e mbajtur me datë 30 tetor 2018, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET versioni i ri i dokumentit "Rregullat e Tregut v3.0"

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit "Rregullat e Tregut v3.0" nga KOSTT.
- o Hartimi i versionit të ri i Rregullave të Tregut ka filluar në vitin 2017, për të mundësuar harmonizimin me ligjet e reja të energjisë, si dhe përshtatjes me rrethanat në sektorin e energjisë. Gjatë procesit të hartimit të Rregullave të Tregut janë mbajtur shumë takime, ku kanë qenë të përfshira palët relevante të sektorit të energjisë, të cilat kanë dhënë komentet e tyre. Dokumenti ka qenë në konsultim publik, si dhe është dërguar për komentim në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.
- o ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumentit dhe ka dhënë komentet e veta si drejtpërdrejt në takimet e mbajtura, gjithashtu edhe në formë të shkruar.




- Dokumenti Rregullat e Tregut v3.0 është i rëndësishë së veçantë, dhe përmban ndryshimet e bazuara në ligjet e reja të energjisë dhe kërkesat e pakos së tretë të BE për energji.
- Bazuar në këtë, ZRRE konsideron se dokumenti i përmbush kriteret e nevojshme dhe bënë aprovimin e versionit të ri të dokumentit “Rregullat e Tregut v3.0”, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit.
- Me hyrjen në fuqi ky dokumentit “Rregullat e Tregut v3.0” shfuqizon dokumentin, “Rregullat e Tregut v2.0” të aprovuara në vitin 2013.
- Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së




Arsim Janova, u.d. kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar